

**Kontroll-revizion i Programeve të
Rindërtimit në Evropën Juglindore
nga Perspektiva e Përkatësisë Gjinore**

Chris Corrin

për

Komisionin e Grave për Gratë dhe Fëmijët Refugjatë
dhe
Fondin për Ndërhyrje Urgjente

Fondi për Ndërhyrje Urgjente u krijua në tetor 1997 për të përkrahur të drejtat e grave në kuadrin e strategjive të parashtruara në Platformën për Veprim të Pekinit. Fondi ka për qëllim të inkurajojë ndryshime strukturore që çojnë në përparimin e të drejtave të grave. Fondi për Ndërhyrje Urgjente është një rrjet njerëzish të përkushtur ndaj barazisë dhe drejtësisë shoqërore. Kjo organizatë ofron ndihmë financiare të menjëhershme për situata të paparashikuara dhe urgjente ku rrezikohen të drejtat e grave.

Komisioni i Grave për Gratë dhe Fëmijët Refugjatë ka për qëllim të përmirësojë jetën e grave dhe fëmijëve refugjatë përmes një programi të fuqishëm të edukimit publik e përkrahjes dhe duke shërbyer si burim ndihme teknike. Komisioni, i krijuar në 1989 nën ombrellën e Komitetit Ndërkombëtar të Shpëtimit, është e vetmja organizatë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës që i përkushtohet ekskluzivisht mbrojtjes së grave që janë detyruara të zhvendosen për shkak të persekutimit gjatë konflikteve të armatosura.

Ky raport u përgatit nga Dr. Chris Corrin, drejtore e Qendrës për Studime mbi Gratë në Universitetin e Glasgout në Skoci. Raporti u redaktua nga Jan Bauer, Ariane Brunet, Mary Diaz, Delina Fico, Rachel Wareham, Julie Shaw dhe Suvira Chaturvedi. Në mënyrë të veçantë falenderojmë Grupin Këshëllimor për këtë projekt: Jan Bauer, Anne Gallagher, Vjollca Krasniqi, Nada Ler Sofronic dhe Rachel Wareham. Organizatorët dëshirojnë të falenderojnë po ashtu Qendrën Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut dhe Zhvillimet Demokratike, si dhe Rrjetin e Grave të Institutit për Shoqërinë e Hapur, në mënyrë të veçantë Debra Schultz.

Nëse citoni nga ky raport, lutemi të përmendni Fondin për Ndërhyrje Urgjente dhe Komisionin e Grave për Gratë dhe Fëmijët Refugjatë.

Komisioni i Grave për Gratë dhe Fëmijët Refugjatë
122 E. 42nd Street
New York, NY 10168
Tel: (1 212) 551 3111
E-mail: wcrwc@intrescom.org

Fondi për Ndërhyrje Urgjente
P.O. Box 1138
Fairfax, CA 94978-1138
E-mail: Urgentact@aol.com

TRYEZA E LËNDËS

Parathënie	4
Përmbledhje	5
Hyrje	6
Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë	8
Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore	33
Shtojca	41

PARATHËNIE

Që prej vitit 1997 Fondi për Ndërhyrje Urgjente (UAF) ka ndihmuar në 23 raste në mbrojtje të të drejtave të grave dhe vajzave në 16 zona konfliktesh në rajone të ndryshme të botës. Aktualisht, me mbështetjen e Fondacionit Ford e në partneritet me Qendrën për të Drejtat e Njeriut dhe Zhvillimet Demokratike (ICHRDD) dhe Komisionin e Grave për Gratë dhe Fëmijët Refugjatë, UAF ka ndërmarrë nismën për të forcuar rolin e grave në ndërtimin e një politike koherente dhe të ndjeshme ndaj perspektivës së përkatësisë gjinore lidhur me të drejtat e njeriut dhe zhvillimet demokratike në të gjithë Evropën Juglindore.

Vendimi për të ndërmarrë një kontroll-revizion nga perspektiva e përkatësisë gjinore përpara se të formohej Forumi mbi Probleme të Përkatësisë Gjinore u bazua në informacionin e mbledhur gjatë vizitës së Ariane Brunet, bashkërenduese e Fondit për Ndërhyrje Urgjente, në disa vende të Evropës Juglindore në shkurt 2000. Dukej qartë se projekti i UAF duhej rishikuar, duke i kushtuar vëmendje të veçantë nevojës për një vlerësim të efektit të programeve të rindërtimit dhe të marrëveshjeve të paqes në rajonin e Ballkanit. Po ashtu, dukej qartë se analiza e efektivitetit të këtyre programeve nga perspektiva e përkatësisë gjinore – ose kontroll-revizioni nga perspektiva e përkatësisë gjinore - duhet të fokusohet, në rradhë të parë, në Administratën e Përkohshme të Kombeve të Bashkuar në Kosovë (UNMIK) dhe në Paktin e Stabilitetit për Evropën Juglindore. Pasi ky raport të jetë shpërndarë dhe diskutuar në rajon, UAF do të shohë nëse organizatat joqeveritare (OJQ) vendase dëshirojnë ta çojnë më tej Nismën në Fushën e Problemeve të Përkatësisë Gjinore. Ne shpresojmë se ky raport do të ndihmojë për të forcuar bashkëpunimin mes OJQ-ve vendase, OJQ-ve ndërkombëtare, organizmave dhe agjensive ndërqeveritare në punën e tyre për të arritur barazinë gjinore.

UAF, në bashkëpunim me Komisionin e Grave për Gratë dhe Fëmijët Refugjatë dhe me mbështetjen e Fondacionit Ford, ngarkoi studiuesen Chris Corrin nga Universiteti i Glasgout për të kryer këtë studim, mbi të cilin bazohet Kontroll-revizioni i Programeve të Rindërtimit në Evropën Juglindore nga Perspektiva e Përkatësisë Gjinore. Ky raport synon të ndihmojë gratë dhe grupet e grave në Evropën Juglindore për të vlerësuar mundësitë dhe pengesat për bashkëpunimin me bashkësinë e donatorëve ndërkombëtarë. Ne shpresojmë se ky raport do të përdoret nga OJQ për të përcaktuar mënyra për të punuar në mënyrë konstruktive me bashkësinë ndërkombëtare, qeveritë e OJQ ndërkombëtare. Në shpresojmë se raporti do të përdoret, po ashtu, edhe nga bashkësia e donatorëve ndërkombëtarë për të identifikuar nevojat që duhen plotësuar, për të përcaktuar mekanizmat e bashkëpunimit dhe për të krijuar mjete për zbatimin e programeve të ndryshme lidhur me përfshirjen e problemve të përkatësisë gjinore në të gjitha fushat.

PËRMBLEDHJE

Nëse marrim në konsideratë administrimin e ndryshimeve në Kosovë në planin politik, shoqëror dhe ekonomik, bëhet e qartë se gratë kanë qenë të diskriminuara gjatë procesit të rindërtimit. Për pasojë, kontributi potencial i grave është lënë pas dore dhe në disa raste është penguar. Kjo duket qartë në mungesën e përpjekjeve të bashkësisë ndërkombëtare për të përfshirë perspektivën gjinore në proceset politike dhe në përpunimin e politikave. Për shembull:

- Pak gra janë caktuar në pozicione kyçe për marrjen e vendimeve. Asnjë grua nuk u caktua të marrë pjesë në Këshillin Transitor të Kosovës, i cili është në rangun e një kabineti qeveritar. Nga 20 departamentet qeveritare, vetëm 2 drejtohen nga gra kosovare dhe vetëm njëra prej tyre është e pavarur (nuk përfaqson ndonjë parti politike).
- Nuk është vlerësuar dhe dokumentuar roli i grave kosovare në zhvillimet politike aktuale, puna e tyre në sistemin paralel që prej vitit 1990, pjesëmarrja e tyre në luftë dhe anagazhimi i tyre shumë i rëndësishëm në proceset e rindërtimit, në nivel lokal dhe rajonal, në Kosovë që prej vitit 1999.
- Një numër i madh grash në Kosovë kanë humbur anëtarët meshkuj të familjes dhe janë tani kryefamiljare. Megjithatë, nevojat e këtyre grave janë lënë pas dore.
- Në përpjekjet për të ristrukturuar skenën politike në Kosovë, disa nga vendim-marrësit në UNMIK kanë zgjedhur një stil pune nga lart-poshtë, duke u konsultuar vetëm me ata burra që konsiderohen si persona të rëndësishëm. Ky qëndrim u ka mohuar udhëheqësve të bashkësive lokale, OJQ-ve vendase dhe grupeve të tjera të bashkësisë të drejtën e fjalës në sistemet e reja të porsakrijuara. Mungesa e pjesëmarrjes nga ana e bashkësisë lokale në proceset e ndryshimeve ka sjellë mungesën e besimit nga ana e tyre për këto procese.
- Pjesa më e madhe e fondeve është kanalizuar përmes organizmave ndërkombëtarë, të cilat disa herë duket se kërkojnë mënyra të përshtatshme për t'i shpenzuar këto fonde. Por, nëse ndiqet kjo rrugë, mund të ndodhë që organizatat vendase të zhvillohen *vetëm në përgjigje* të nevojave ndërkombëtare dhe, për këtë arsye, të varen nga financimet ndërkombëtare. Vendimi për të kanalizuar fondet përmes grupeve ndërkombëtare ombrellë ka penguar gjithashtu zhvillimin e grupeve vendase që punojnë me gratë në bazë.
- Ndonëse statistikat e disagreguar sipas seksit dhe moshës janë një përbërës shumë i rëndësishëm për integrimin e grave dhe të vajzave në të gjitha problemet ekonomike, shoqërore dhe politike, mbledhja e këtyre statistikave nuk është ende një përparësi në Kosovë.

Duke marrë parasysh sa u tha më lart si dhe probleme të tjera, është e nevojshme që të vlerësohet se sa shpejt dhe në ç' masë mund të zhvillohen proceset e integritit të grave në fushat kyçe të rindërtimit dhe reabilitimit politik, ekonomik dhe shoqëror. Këto fusha përfshijnë:

- pjesëmarrjen në edukimin lidhur me të drejtat e grave dhe zhvillimet demokratike,
- krijimin e mundësive që gratë të përfshihen në strukturat e marrjes së vendimeve,

- krijimin e mekanizmave për të lehtësuar integrimin e grave në të gjitha fushat e jetës ekonomike dhe shoqërore.

HYRJE

Ky Kontroll-Revizion nga Perspektiva e Përkatësisë Gjinore bën një vlerësim të programeve të rindërtimit për Evropën Juglindore. Raporti përqendrohet kryesisht në ndikimin e këtyre programeve mbi vajzat dhe gratë, duke përfshirë edhe shkallën e përfshirjes nga ana e bashkësisë ndërkombëtare të grave dhe vajzave në procesin e rehabilitimit dhe të rindërtimit. Ky raport ka marrë në analizë këto programe kryesore: (a) Administratën e Misionit të Përkohshëm të OKB-së në Kosovë (UNMIK), e cila u krijua në vijim të rezolutës së Këshillit të Sigurimit nr. 1244, 10 qershor 1999; (b) Paktin e Stabilitetit për Evropën Juglindore, për të cilin u ra dakort në Këln, 10 qershor 1999; (c) Deklaratën e Sarajevës të datës 30 korrik 1999 (në kontekstin e Paktit të Stabilitetit).

Çështja kryesore me të cilën merret ky raport ka të bëjë me shkallën në të cilën është inkurajuar rritja e pjesëmarrjes së grave në fushat shoqërore, ekonomike, edukative dhe politike (në sektorët e organizmat “informalë” dhe në nivelet formale të pushtetit). Për hir të vazhdimësisë dhe në shërbim të projekteve të ardhshme, ky raport vë në pah boshllëqet në përpunimin e politikave, në sigurimin e shërbimeve, në mbledhjen e të dhënave dhe në bashkërendimin e monitorimin e projekteve që kanë për synim rritjen e pjesëmarrjes së grave dhe vajzave. Në të ardhmen do të zhvillohen propozime për hetime të mëtejshme të këtyre problemeve dhe për bashkëpunime të mëtejshme. Ne shpresojmë që ky raport do të sugjerojë dhe do të frymëzojë përpjekje të reja për hetimin dhe monitorimin e këtyre programve, me qëllim që të sigurohet integrimi i plotë i grave dhe vajzave në proceset e rindërtimit në Evropën Juglindore.

ANALIZA NGA PERSPEKTIVA E PËRKATËSISË GJINORE

Fjala “përkatësi gjinore” shënon rolet e grave dhe të burrave, të përcaktuara nga pikëpamja kulturore, shoqërore, ekonomike dhe historike. Ky koncept shërben për të kuptuar se si janë krijuar marrëdhëniet e pabarabarta të pushtetit mes grave e burrave dhe se si këto marrëdhënie kanë marrë formë në institucionet shoqërore si familja, sistemi ligjor, sistemet dhe besimet fetare. Rolet e ndryshme gjinore mësohen që nga momenti i lindjes së njeriut në një kontekst të caktuar shoqëror nga burime të ndryshme brenda një kulture të caktuar. Duke qenë se këto role nuk janë të përcaktuara biologjikisht, ato mund të ndryshohen dhe në fakt, kanë ndryshuar. Analiza nga perspektiva e përkatësisë gjinore është baza në të cilën mbështeten programet e përgatitjes dhe zhvillimit që sigurojnë përparimin e barabartë të grave dhe burrave në proceset e rindërtimit dhe të rintegritimit. Të punosh duke u nisur nga perspektiva e përkatësisë gjinore do të thotë të marrësh parasysh rolet, nevojat, angazhimin dhe marrjen e vendimeve nga gratë dhe nga burrat në një bashkësi.

Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) është angazhuar ndaj barazisë gjinore në të gjitha politikat dhe programet e saj. Raporti i Këshillit Ekonomik dhe Shoqëror (1997) e përcakton përfshirjen e problemeve të përkatësisë gjinore si më poshtë:

Procesi i vlerësimit të pasojave të një veprimi të caktuar mbi burrat dhe gratë, duke përfshirë legjislacionin, platforma ose programe, në të gjitha fushat dhe në të gjitha nivelet. Kjo është një strategji që synon t'i bëjë shqetësimet e grave dhe të burrave pjesë integrale të përpunimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të politikave e programeve në të gjitha sferat politike, ekonomike dhe shoqërore, në mënyrë që gratë dhe burrat të përfitojnë në mënyrë të barabartë nga këto programe dhe pabarazia të mos thellohet më shumë. Qëllimi final është arritja e barazisë mes dy gjinive.¹

Duke mbajtur parasysh anagazhimin e bashkësisë ndërkombëtare për të përfshirë perspektivën e përkatësisë gjinore kudo, të bësh analizën nga perspektiva e përkatësisë gjinore të projekteve e programeve të reabilitimit dhe të rindërtimit që po zbatohen nga strukturat e UNMIK-ut në Kosovë, do të thotë të marrësh në konsideratë pasojat që këto programe kanë veç e veç mbi gratë dhe burrat. Kjo kërkon të merret në konsideratë roli që luajnë gratë në bashkësitë e tyre, në prodhim dhe në riprodhim, si dhe të kuptohet roli që luajnë burrat nga pikëpamja ekonomike dhe shoqërore. Duke kuptuar

¹Raporti i Këshillit Ekonomik dhe Shoqëror i Kombeve të Bashkuara, 1997.

mënyrat si bashkëvepron një bashkësi ose një grup dhe duke bërë të mundur që pikëpamjet e grave dhe të burrave të merren parasysh në atë bashkësi ose shoqëri, mund të bëhen përpjekje për t'i përfshirë ata në mënyrë aktive në projektet përkatëse dhe në marrjen e vendimeve. Duke marrë parasysh situatën krejt të pazakontë në Kosovë - ku UNMIK ka krijuar një administratë në partneritet me politikanë e persona të pavarur vendas - këto procese duhet të jenë të dyanshme dhe transparente. Disa pika kyçe në këto procese janë: (a) nevoja për të dhëna statistikore sipas sekseve, në mënyrë që të studiohen raportet gra/vajza dhe burra/djem në fusha të ndryshme; (b) marrjen në konsideratë të pasojave të ndryshme që politika të caktuara kanë mbi grupe të ndryshme dhe; (c) përfshirja e perspektivës gjinore në të gjithë administratën dhe në marrjen e vendimeve.

MISIONI ADMINISTRATIV I PËRKOHSHËM I OKB-SË NË KOSOVË (UNMIK)

Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara me rezolutën 1244 (shih shtojcën II), 10 qershor 1999, vendosi të krijojë në Kosovë një administratë civile ndërkombëtare të përkohshme. Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së më 12 korrik 1999² parashtrori një platformë të plotë për ndërhyrjen ndërkombëtare të udhëhequr nga OKB-ja. Kjo rezolutë i ka dhënë UNMIK-ut autoritet mbi territorin dhe popullësinë e Kosovës, duke përfshirë të gjitha fuqitë legjislative dhe ekzekutive, si dhe administrimin e sistemit të drejtësisë. Rezoluta 1244 e udhëzoi UNMIK-un “të krijojë një administratë të përkohshme për Kosovën, ... e cila do të sigurojë administrimin gjatë një periudhe tranzicioni, ndërkohë që do të krijojë dhe mbikqyrë zhvillimin e institucioneve provizore të vetëqeverisjes për të krijuar kushtet për një jetë normale dhe paqësore të të gjithë banorëve të Kosovës”³. Detyrat kyçesore të UNMIK-ut janë:

- të nxisë krijimin e një autonomie të konsiderueshme dhe të vetëqeverisjes në Kosovë,
- të kryejë funksionet bazë të një administrate civile,
- të lehtësojë procesin politik për vendosjen e së ardhmes së statusit të Kosovës,
- të mbështesë rindërtimin e infrastrukturës, si dhe ndihmën humanitare e në raste fatkeqësie,
- të ruajë rendin publik,
- të përkrahë respektimin e të drejtave të njeriut,
- të sigurojë kthimin e sigurtë dhe pa pengesa të të gjithë refugjatëve dhe personave të zhvendosur në shtëpitë e tyre në Kosovë.

Me qëllim që të përmbushë mandatin e mësipërm dhe për të rritur pjesëmarrjen e bashkësive kosovare në qeverisjen e Kosovës, UNMIK krijoi një Strukturë të Administratës së Përbashkët të Përkohshme për Kosovën (JIAS). Kjo strukturë përbëhet nga 20 departamente administrative, të cilat

²Raport i Sekretarit të Përgjithshëm, S/1999/779.

³Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit, op. 10.

konsiderohen si trupa administrative qendrorë. Secili nga këto departamente ka një drejtues nga UNMIK dhe një drejtues kosovar. Bashkë-drejtuesit raportojnë përpara Këshillit Administrativ të Përkohshëm (IAC) përmes njërit prej Zëvendësve të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (DSRSG), të cilët, së bashku me disa udhëheqës kosovarë, përbëjnë IAC. Detyrat e UNMIK-ut janë ndarë në katër sektorë, të njohur si “katër shtyllat”. Këto detyra po zbatohen në pesë faza të integruara. Deri më 31 Mars 2000, këto katër shtylla ishin: (a) ndihma humanitare, (b) administrata civile, (c) demokratizimi dhe ndërtimi i institucioneve, dhe (d) ristrukturimi ekonomik. Më 1 prill 2000, shtylla I nuk ishte më në veprim. Sidoqoftë, puna e nisur në kuadrin e kësaj shtylle është në vazhdim.

SHTYLLA I: NDIHMA HUMANITARE, nën udhëheqjen e Zyrës së Komisionerit të Lartë të OKB-së për Refugjatët (për këtë raport, hollësitat lidhur me shëndetin dhe edukimin janë trajtuar si aspekte themelore).

Fokusi kryesor i punës së UNHCR lidhur me nevojat e grave dhe rehabilitimin e tyre ka qenë Nisma për Gratë Kosovare (KWI), e cila është financuar nga Zyra e Departamentit të Shtetit të SHBA-së për Popullsinë, Refugjatët dhe Migracionin (BRMP). Qeveria amerikane ka dhënë 10 milionë dollarë për KWI. Kjo shumë, e konsideruar si ndihmë humanitare në kushte të emergjencës, ishte planifikuar të shpenzohej shumë shpejt, në më pak se një vit. Duke qenë se faza e fillimit të projekteve në kuadrin e KWI mori më shumë kohë se ç'pritej, për shkak të mungesës së strukturave organizative, ligjore, financiare, etj., periudha e realizimit të kësaj nisme është zgjatur edhe për një vit.

Puna e kryer në fushën e kujdesit shëndetësor deri më 1 prill 2000

Në vend që të financojë rigjallërimin e sistemit të mëparshëm shëndetësor, UNMIK ka ndërmarrë përpjekje për të hedhur bazat e një sistemi më të mirë të kujdesit shëndetësor. Në korrik 1999 u përpunuan udhëzimet lidhur me shëndetësinë dhe në shtator u bënë të njohura publikisht Udhëzimet për Politikën Shëndetësore të Përkohshme në tri gjuhë (shqip, anglisht dhe serbisht). Në përputhje me Regulloren 10, u krijua një Administratë për Shëndetin në të gjithë 20 departamentet e JIAS. Me kalimin e kohës të gjitha bashkitë do të kenë administratën shëndetësore përkatëse. Administrata funksionon si një Ministri e Shëndetësisë. Ajo zhvillon infrastrukturën, forcën e punës dhe përgatit udhëzime. Në fazat e para të zhvillimit, puna e kësaj administrate kishte natyrë humanitare dhe kryhej pothuajse vetëm nga organizata joqeveritare ndërkombëtare. Puna u fokusua në këto fusha: imunizimi i fëmijëve, ngrohja për maternitetet, kurse kualifikimi për punonjësit e shëndetësisë, sigurimi i materialeve për shëndetin riprodhues dhe sigurimi i shërbimeve të shëndetit mendor. Në perspektivën e një zhvillimi afatgjatë, organizatat ndërkombëtare filluan të përgatisin programe për të kualifikuar infermierët, një profesion ky ku punojnë kryesisht gra. (Në të gjithë ish-Jugosllavinë ka pasur shumë pak infermiere me nivel të lartë kualifikimi). Në këtë frymë, në bashkëpunim me Fondin e OKB-së për Veprimtari lidhur me Popullsinë (UNFPA), janë planifikuar trajnime për mamitë, doktorët dhe infermierët.

Njëkohësisht, në kuadrin e përgatitjes së buxhetit të konsoliduar për Kosovën, Administrata u angazhua më shumë në menaxhimin e spitaleve dhe në sigurimin e ilaçeve e të mjeteve të tjera të nevojshme. Theksi u vu në zhvillimin e kujdesit për shëndetin parësor dhe për të ndryshuar sistemin e kujdesit shëndetësor nga ai institucional në një sistem të mbështetur mbi shërbime në funksion të bashkësive përkatëse.

Analiza e punës së bërë në sigurimin e kujdesit shëndetësor dhe në rindërtimin e sistemit të shëndetësisë tregon se, në përgjithësi, OJQ-të ndërkombëtare dhe agjensitë e OKB-së përmes trajnimeve për punonjës të shërbimit shëndetësor kanë bërë të pranishme problemet e dhunës mbi bazën e përkatësisë gjinore dhe mbi bazë seksuale. Po ashtu, vëmendje më e madhe i është kushtuar kujdesit për nënën si dhe praktikave mjekësore në shërbim të publikut. Megjithatë, kritikët e proceseve të rindërtimit në Kosovë vënë në dukje: (a) faktin që, pavarësisht nga deklaratat, për sa i përket financimit, kujdesi për shëndetin parësor nuk është trajtuar si përparësi dhe u është dhënë më shumë përparësi

spitaleve, (c) nevojën për të gjetur më shumë rrugë për të komunikuar me gratë në zonat fshatare e për t’ju ofruar atyre shërbim shëndetësor; (d) faktin që doktorët dhe infermierët në spitalet e Nënë Terezës në zonat fshatare janë larguar për në qytet e në punë të paguara më mirë, gjë që ka sjellë pasoja serioze në shërbimin shëndetësor për gratë në zonat fshatare. (Shoqata “Nënë Tereza” ishte shoqata më e madhe e ndihmës humanitare, e cila gjatë luftës siguroi ushqim dhe ndihmë shëndetësore për mijëra kosovarë, refugjatë dhe të zhvendosur brenda Kosovës). Kritikët thonë po ashtu se shumë pak vëmendje i është kushtuar programeve të tilla mbi bazë bashkësie, si, p.sh., shërbime për të moshuarit, shërbime për të uriturit dhe shërbime për personat me aftësi të kufizuara.

Puna në fushën e edukimit deri më 1 prill 2000:

Një vlerësim i gjendjes së shkollave i kryer nga Fondi i OKB-së për Fëmijët (UNICEF) tregon se deri në nëntor 1999 vetëm 784 nga 1,050 ndërtesa shkollash ishin akoma në këmbë. Nga këto, 45% kishin pësuar dëme të rënda. Deri në pranverë 2000 ishin riparuar dhe funksiononin më shumë se 400 shkolla. Po ashtu, deri në këtë periudhë ishin në funksionim edhe disa shkolla të tjera që nuk kishin nevojë për riparim.

Por, kur UNMIK filloi të angazhohej me detyra të tjera, procesi i rinovimit mori fund. Kritikët e UNMIK-ut thonë se: (a) për një periudhë prej disa muajsh, ndërsa po përgatiteshin udhëzimet e reja, puna u ndërpre; (b) standartet cilësore përfshijnë udhëzime të shumta që janë shumë të komplikuar për t'u lexuar dhe për t'u kuptuar; (c) vlerësimi i gjendjes së shkollave nga UNMIK mori rreth katër muaj, kohë e humbur kjo në përpjekjet për t'i kthyer të rinjtë në shkollë; (d) procesi i konkurimit për oferta nga ana e OJQ-ve ndërkombëtare për projekte që më pas zbatohen nga kontraktorë vendas, e ka ngadalësuar procesin; (e) pavarësisht se tekstet shkollore bazë ishin gati që në gusht 1999, ato nuk u shtypën deri në prill 2000; (f) nxënësit kanë shumë pak mundësi për të udhëtuar për në shkollë dhe ky udhëtim kushton shumë; (g) i është kushtuar fare pak vëmendje ndjekjes së shkollës prej vajzave; (h) duket se mungon koncepti i arsimit për të rriturit, një aspekt ky shumë i rëndësishëm për gratë që kanë shkallë të ulët arsimimi; (i) ndonëse OJQ vendase i kanë kushtuar rëndësi çështjes së arsimit të të rriturve, strukturat shtetërore kanë bërë pak ose aspak përpjekje në këtë drejtim.

Ka të dhëna se reforma në universitet - duke përfshirë këtu probleme të metodave të mësimdhënies dhe standartet e të mësuarit në të gjithë arsimin e lartë -, mbetet një sfidë e madhe. Ka rrezik që, në mungesë të reformimit të arsimit të lartë, klasa e mesme e Kosovës të shkatërrohet.

Lidhur me vajzat, ka mundësi që trauma e pasluftës, varfëria dhe pasiguria t'i pengojë një numër prej tyre të mbarojnë klasën e tetë. (Në 1997 përqindja e vajzave që lanë shkollën ishte 34%. Megjithëse aktualisht nuk ka të dhëna lidhur me këtë tregues, specialistët në fushën e arsimit që punojnë në rajon, kanë vënë re se përqindja e vajzave që e kanë lënë shkollën është shumë e lartë). Rritja e kostos së udhëtimit për në shkollë dhe kufizimet ekonomike janë bërë pengesë për familjet që dërgojnë vajzat e tyre në shkollë. Ndonëse në disa zona grupe vendase kanë organizuar mësim shtesë për vajzat, katër janë arsyt kryesore për shkallën e lartë të lënies së shkollës nga vajzat: (a) Siguria – frika nga sulmet fizike ose përdhunimi; (b) Varfëria – djetmë preferohen në raport me vajzat, këto të fundit mund të bëjnë punë shtëpie ose të punojnë tokën; (c) Mungesa e dëshirës – vajzat shpesh nuk duan të shkojnë në shkollë për shkak se ato nuk inkurajohen në shkollë apo në shtëpi; (d) Moshë – faktor ky që pasqyron frikën se vajzat që janë në vitet e fundit të adoleshencës do të konsiderohen të mëdha në moshë për të gjetur burrë. Si edhe në fushën e kujdesit shëndetësor, fëmijët që kanë vështirësi të veçanta në të mësuar nuk janë përfshirë plotësisht në sistemin ekzistues arsimor dhe shumë fëmijë me aftësi të kufizuara nuk e ndjekin shkollën.

Reabilitimi juridik dhe civil

Seksioni i dokumentave civile i UNMIK-ut po lëshon çertifikata lindjeje, martese dhe vdekjeje në 29 bashkitë e Kosovës. Ndërkohë kanë filluar përgatitjet për rregjistrimin civil. UNMIK do të lëshojë karta identiteti për dy milionë kosovarë, proces ky që lidhet me zgjedhjet dhe regjistrimin e votuesve.

Sidoqoftë, nuk ka ndonjë siguri që të dhënat e mbledhura gjatë këtij procesi do të jenë të disagreguara sipas seksit dhe moshës.

Përsa i përket reabilitimit juridik, UNMIK ka krijuar një Sistem Juridik të Emergjencës që përbëhet nga katër gjykata të rrethit, një gjykatë ad hoc të apelit final dhe një Zyrë të Prokurorit Publik. Një Kod i ri Penal po përpunohej në mars 2000. OSBE-ja po punon me grupe ligjore në disa prioritete kyçe mbi dhunën seksuale, dhunën në familje dhe drejtësinë për të rinjtë. Sidoqoftë, mungesa e funksionimit të një sistemi të plotë ligjor ka pasoja, sepse ligjet tradicionale e vënë gruan në një pozitë të disfavorshme. Në kushtet ku gjykatat janë të dobta, ndodh rrallë që gratë të kenë një trajtim të favorizuar kur është fjala për marrjen në kujdestari të fëmijëve. Po ashtu, si rregull grave nuk u njihet e drejta për pronësi dhe në rastet e dhunës ndaj grave dhe fëmijëve (duke përfshirë inçestin), gjykatat kanë tendencë ta lënë të lirë burrin dhe/ose babain me justifikimin e “mungesës së provave”, pavarësisht nga fakti që mund të paraqiten si dëshmi fotografitë dhe pohimet e dëshmitarve.

SHTYLLA II: ADMINISTRATA CIVILE, nën OKB-në dhe ndihma ndaj Bashkësive në Rrezik

Dhuna në familje është mjaft e përhapur në Kosovë dhe ka shumë pak shërbime që u përgjigjen nevojave psikologjike dhe materiale të viktimave të kësaj dhune. Mjetet e përkrahjes për gratë që janë viktimat të abuzimit janë të ndryshme nga njëri rajon e kulturë në tjetrën; strehëzat afat-gjata nuk janë alternativa më e mirë, ndërkohë që viktimat kanë nevojë për mbështetjen e familjes dhe të bashkësisë.

Në kushtet e pranisë së një numri të madh punonjësish ndërkombëtarë të shumtë në numër, çështja e prostitucionit dhe trafikimit ka marrë një rol qendror. Më shumë se sa një rrugë për trafikantët, Kosova është kthyer në destinacion final për prostitucionin. Në kuadrin e kësaj situatë, janë identifikuar disa nevoja, duke përfshirë: (a) kode të përcaktuar të sjelljes për të gjithë punonjësit ndërkombëtarë në Kosovë; (b) zbatimin e sanksioneve reale kundër shfrytëzimit të grave; (c) zbatimin nga ana e UNMIK-ut të ligjeve që ekzistojnë lidhur me trafikimin; mënjanimin e kriminalizimit të viktimave të trafikimit, siç ndodh në rastet kur gratë akuzohen dhe dënohen për prostitucion.

Vazhdimi i dhunës ndaj grave ngre një sërë problemesh. Është e qartë që OJQ ndërkombëtare, UNMIK dhe grupet vendase duhet të përmirësojnë punën në përgjigje të kësaj dhune. Më parë, gratë, më shumë se kudo, drejtohen për në Qendrat për Punë Sociale. Këto qendra, të krijuara që në 1974, ndihmonin viktimat e dhunës për të gjetur punë e strehim. Para luftës ekzistonin 22 qendra të tilla dhe ato punësonin 200-400 njerëz. Pavarësisht se shumë nga njerëzit që kishin punuar në këto qendra, u mblodhën së bashku për t'i rindërtuar ato (vetëm ndërtesa e një qendre të tillë në Gjakovë ishte gati për t'u vënë në përdorim), nuk u gjetën financime për pagat e punonjësve. Në prill 2000, kur punonjësit filluan të paguhen, disa prej tyre ishin detyruar tashmë të gjenin punë të tjera.

Grupet kosovare të ndihmës

Ka më shumë se 50 organizata vendase kosovare dhe 15 prej tyre punojnë në fushën e problemeve të grave. Mes tyre mund të përmendim:

- **Aureola**, e themeluar në janar 1996 mbi bazën e veprimtarive vullnetare humanitare, të cilat filluan në 1989. Qëllimi kryesor i kësaj organizate është të ndihmojë popullsinë shqiptare të Kosovës lidhur me problemet e të drejtave të njeriut, paqes, shëndetësisë dhe edukimit.
- **Lidhja e Grave Shqiptare (LGSH)** ka punuar që prej 1992 në të gjithë Kosovën për të krijuar mundësi për punësim e për edukim. Qëllimi kryesor i LGSH-së sot është të ndihmojë gratë dhe fëmijët e prekur nga lufta. Në 2000 LGSH ngriti një Qendër të Grave në Prishtinë.
- **Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve** e filloi punën në 1993 në fushën e shërbimit shëndetësor, të drejtave riprodhuese dhe të drejtave e grave e të fëmijëve. Gjatë luftës kjo qendër dokumentoi abuzimet e të drejtave të njeriut dhe tashmë është fokusuar në viktimat e përdhunimeve – mblledhjen e dëshmimeve, mbrojtjen e dëshmitarëve, seminare dhe veprimtari të tjera.
- **Flaka** është themeluar në 1998 dhe ka 20 anëtare nga bashkia e Lipjanit (70 fshatra). Synon të krijojë pesë qendra që do të ofrojnë kurse për rrobaqepësi dhe rregulim flokësh, si dhe mbështetje emocionale për persona të zhvendosur.

- **Jehona** e ka filluar punën në 1999, kur gjashtë aktiviste nga Fushë Kosova punuan së bashku me OXFAM-in për të krijuar një shoqatë të pavarur të grave. Ofrojnë kurse për rrobaqepësi dhe thurje.
- **Legjenda** ka punuar në 20 fshatra të bashkisë së Vitit që prej 1996. Synimi është përmirësimi i pozitës së grave në shoqëri. Përqendrohet në mbështetjen emocionale për gra dhe fëmijë të prekur nga lufta.
- **Liria** e zhvillon veprimtarinë në Gjilan në fushën e edukimit shëndetësor dhe të arsimit të përgjithshëm në shtëpi private.
- **“Motrat Qiriazit”** (MQ) punon me gratë dhe vajzat fshatare për t’i ndihmuar e për t’i aftësuar ato që të marrin nën kontroll jetën e për të bërë ndryshime pozitive për veten e tyre dhe për bashkësitë përkatëse.
- **NORMA** përbëhet nga grupe gjykatësesh dhe avokatësh që punojnë për të siguruar ndihmë dhe këshillim juridik për gratë. Bashkëpunon me UNHCR për të analizuar dhe përkthyer ligjet dhe procedurat ligjore, si dhe në përhapjen e informacionit për probleme të përkatësisë gjinore – të drejtat e pronësisë për gratë, ndjekja penale e dhunës në familje, divorci dhe të drejtat e trashëgimisë.
- **Radio 21**, e themeluar në 1995, trejton vajzat e reja në zgjidhjen e konflikteve dhe në fushën e gazetarisë për radio e televizion. Para 1999 ka botuar 11 numra të Eritreas (termi latin për “gra shqiptare”). Mbështet Rrjetin e Grave të Reja të Kosovës.
- **Sfinga** u themelua në 1997. Qendra e Grave e kësaj shoqate inkurajon gratë studiuese të zhvillojnë krijimtari shkencore, artistike, dhe profesionale. Boton revistën “Sfinga” dhe mbështet studimet në fushën e problemeve të përkatësisë gjinore.

Organizata dhe Nisma Ndërkombëtare

Disa nga organizatat e shumta ndërkombëtare që punojnë në Kosovë janë:

- **Kvinna till Kvinna Prishtinë** që prej vitit 1994 ka mbështetur forcimin e kapacitetit institucional të grupeve të grave. Kjo organizatë ka hapur zyrat në Kosovë që prej vitit 1998. Puna e tyre përqendrohet në problemet e trafikut të grave, prostitucionit dhe shëndetit të grave.
- **Medica Mondiale** në Gjakovë. Është e specializuar në trajtimin e traumave tek gratë.
- **Oxfam** e filloi veprimtarinë në Kosovë në mesin e viteve 1990 me një angazhim ndaj punës në terren.
- **Komiteti Ndërkombëtar i Shpëtimit** mbështet **Qendrën për Mirëqenien e Grave** në Pejë. Grupe edukatorësh ofrojnë trajnim për punonjësit e shëndetësisë dhe të tjerë në fushën e dhunës në familje dhe të sulmeve seksuale.
- **Rrjeti STAR** që prej vitit 1993 ka financuar, trejnuar dhe mbështetur krijimin e rrjeteve të OJQ-ve të grave në Ish-Jugosllavi duke e vënë theksin në ndërtimin e kapaciteteve, trajnim dhe krijimin e rrjeteve të bashkëpunimit;

- **Bashkëpunimi në Fushën e Mbrojtjes së Grave** mbështet gratë në Kosovë.

Puna organizative e OKB-së në ndihmë të bashkësive dhe në fushën e problemeve të grave

Në Kosovë vazhdojnë të punojnë një numër agjensish të OKB-së, në bashkëpunim me OJQ të ndryshme ndërkombëtare dhe vendase. Të tilla janë:

- **Komisioneri i Lartë i OKB-së për Refugjatët** (UNHCR) administron Nismën për Gratë Kosovare (KWI), e cila u zhvillua gjatë fazës së emergjencës për të siguruar përfshirjen e grave në proceset e rindërtimit. Puna e UNHCR është fokusuar në gjashtë fusha: nevojat akute për të mbijetuar, mbështetja psiko-sociale dhe ndihma e bashkësisë, shërbime të veçanta të kujdesit shëndetësor, fuqizimi, jetesa, të drejtat dhe mbrojtja ligjore.

- **UNHCR dhe UNICEF** kanë ngritur në disa zona të Kosovës qendra për fëmijët e të gjithë etnive me qëllim që t'u përgjigjen nevojave psiko-sociale të tyre si dhe të inkurajojnë riintegrimin. Këto agjensi ndihmojnë për të riparuar ndërtesat të ndryshme publike, me qëllim që të mundësohet zhvillimi i bashkësive dhe krijimi i rrjeteve mes njerëzve në bazë.
- **Qendra Informative Humanitare e Bashkësive (HCIC)** është krijuar për të nxitur e lehtësuar bashkërendimin mes të gjitha organizatave që janë angazhuar në ndihmën në rast emergjence dhe për rehabilitim. HCIC punon për të mbledhur e shpërndarë informacion dhe për të krijuar lidhje mes programeve humanitare dhe shtyllave të tjera të UNMIK-ut.
- **Fondi i Zhvillimit i OKB-së për Gratë (UNIFEM)** krijoi Grupin e Punës për Problemet e Përkatësisë Gjinore (the Gender Taskforce) si një grup/forum i disa agjensive për t'i vënë problemet e përkatësisë gjinore në qendër të dialogut e debatit publik dhe për të nxitur dialogun mes agjensive kryesore. UNIFEM përkrah gjithashtu përfshirjen e problemeve të përkatësisë gjinore në fushat kryesore të veprimtarisë përmes mjeteve të ndryshme, me pjesëmarrjen e shtyllave të UNMIK-ut dhe kryetarëve të agjensive, si dhe përmes programeve që janë zbatuar ose do të zbatohen gjatë vitit 2000. Për vitin 2000 vëmendja është përqendruar në fuqizimin ekonomik të grave. Po ashtu, UNIFEM zhvillohen seminare mbi probleme të qeverisjes dhe aftësive udhëheqëse.

Ata që kritikojnë përpjekjet ndërkombëtare në Kosovë, financimet në fushën e problemeve të përkatësisë gjinore dhe shkallën e interesit të treguar për problemet e grave, kanë vënë në dukje, mes të tjerash: (a) mungesën e transparencës dhe të informacionit mbi fondet; (b) nevojën që një person të punojë me grupet lidhur me nevojat për financim dhe aplikimin për fonde, në mënyrë që kriteret të jenë të qarta dhe proceset e udhëzimit të jenë transparente; (c) nevojën për të bërë përkthimin e dokumenteve, udhëzimeve dhe raporteve në shqip dhe serbisht, si dhe nevojën që në mbledhjet me përfaqësues të bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë të ketë përkthim e të mos organizohen vetëm mbledhje në anglisht, ku mund të marrin pjesë vetëm disa gra; (d) nevojën për një bashkëpunim më të ngushtë mes UNHCR, UNIFEM, Organizatës për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), dhe Zyrës për Probleme të Përkatësisë Gjinore.

Zyra për Probleme të Përkatësisë Gjinore

Njësia Këshillimore për Probleme të Përkatësisë Gjinore në Zyrën e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm në UNMIK u krijua me synim që të këshillojë stukturat e UNMIK-ut lidhur me probleme të përkatësisë gjinore. Në fazat e para kjo njësi përcaktoi tri fusha kryesore në shoqërinë kosovare që kërkonin vëmendje të veçantë: (a) përfaqësimin në nivelin e duhur të grave në marrjen e vendimeve; (b) dhunën ndaj grave (duke përfshirë përdhunimin, trafikimin seksual dhe dhunën në familje); (c) përmirësimin e gjendjes ekonomike.

Në mars 2000 kjo njësi u shndërrua në Zyrën për Problemet e Përkatësisë Gjinore. Synimi është që me kalimin e kohës kjo zyrë:

- Në kuadrin e angazhimit të OSBE-së në procesin elektorral, të fillojë projekte pilote, duke u përqendruar në të drejtën e grave për të votuar dhe për të vënë kandidaturën.

- Të krijojë një hapësirë institucionale për të pasur një pikë qendrore për problemet e përkatësisë gjinore në tre shtyllat e tjera (dhe ndoshta edhe në 20 departamentet e JIAS).
- Të arrijë të bindë ushtarakët dhe njësitë e tjera që merren me planifikim se perspektiva e problemeve të përkatësisë gjinore nuk është thjesht një çështje më vete, por një platformë e përgjithshme e të konceptuarit të problemeve.

SHTYLLA III: DEMOKRATIZIMI DHE KRIJIMI I INSTITUCIONEVE, nën drejtimin e Organizatës për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE)

Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit e autorizon UNMIK-n të sigurojë autonomi të gjerë dhe vetadministrim në Kosovë, duke respektuar në të njëjtën kohë sovranitetin dhe integritetin e Republikës Federale të Jugosllavisë (RFJ). Zgjedhjet për pushtetin lokal në shtator 2000 do të shënojnë një çast vendimtar në tranzicionin politik në Kosovë, sepse nëpërmjet këtyre zgjedhjeve administratat lokale do të fitojnë legjitimitet ndërkombëtar. Është shumë e rëndësishme që këto zgjedhje të jenë të lira dhe të rregullta, që qytetarët të informohen sa më mirë rreth problemeve kryesore, (gjë që kërkon një media efektive dhe objektive) dhe që gjithë grupet etnike të marrin pjesë në këto zgjedhje. Deri në prill 2000 ishte e qartë se disa parti politike të sapokrijuara janë relativisht të dobta dhe nuk kanë një platformë politike realiste për të ardhmen. Si pasojë dhe në përgjigje të nevojës për të zhvilluar partitë politike, në 21 mars 2000 OSBE-ja mori përsipër regjistrimin dhe funksionimin e partive politike në Kosovë.

Regjistrimi dhe zgjedhjet

Është krijuar një Grup Pune i Përbashkët për Rregjistrimin (JRT), i cili bashkon veprimtaritë në kuadrin e Shtyllës II (administrata civile) me veprimtaritë në kuadrin e Shtyllës III (ndërtimi i institucioneve). JRT mund të bëhet potencialisht një strukturë e rëndësishme lidhur me mbledhjen e të dhënave sipas përkatësisë gjinore dhe me përfshirje e problemeve të përkatësisë gjinore në të gjitha fushat, sepse JRT është përgjegjës për: (a) proceset e regjistrimit; (b) organizimin e arkivave të humbura ose të konfiskuara; (c) konsolidimin e bazës elektronike të të dhënave në një format që lejon të bësh kërkime në to; (d) rekrutimin dhe trajnimin e stafit vendas dhe ndërkombëtar që do të bëjë regjistrimin; (e) realizimin e programeve të informimit publik mbi procedurat dhe rregullat e regjistrimit; (f) regjistrimin civil dhe regjistrimin si votues të kosovarëve që jetojnë në Kosovë, si dhe regjistrimin si votues të atyre që jetojnë jashtë Kosovës; (g) realizimin e fazës së parë të krijimit të bazës së të dhënave nga regjistrimi civil dhe regjistrimi i votuesve.⁴

Gjatë përgatitjeve për votime, partitë politike në Kosovë iu kërkohet të regjistrohen në administratën civile të OKB-së, në mënyrë që të njihen nga ana ligjore dhe të mund të marrin pjesë në procesin elektoral. Partitë politike duhet të paraqesin statutin dhe programin e tyre. Sipas udhëzimeve të OSBE-së, programi duhet të përfshijë “një angazhim ndaj parimeve demokratike, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe tolerancën ndaj të gjithë njerëzve, pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike”.

Janë ngritur një sërë problemesh lidhur me zgjedhjet e shtatorit 2000 dhe me zgjedhje të tjera që mund t'i pasojnë ato. Një nga këto shqetësime ka të bëjë me faktin se mënyra e kryerjes së regjistrimit të votuesve dhe e edukimit të elektoratit për të marrë pjesë në votime janë të një rëndësie parësore, kur është fjala për përcaktimin e proceseve demokratike të bashkëpunimit dhe mbështetjes nga bashkësia ndërkombëtare për grupet dhe bashkësitë kosovare. Lidhur me pozitën e grave, mund të vihet re një modernizim i disa ideve dhe një proces politik më i hapur. Gratë kanë shprehur shqetësim për disa aspekte lidhur me demokratizimin në përgjithësi dhe me zgjedhjet në veçanti. Këto shqetësime kanë të

⁴Organizata Ndërkombëtare për Migracionin është përgjegjëse për regjistrimin e votuesve që jetojnë jashtë Kosovës.

bëjnë, për shembull,: me faktin që nuk është planifikuar ose organizuar deri më tash ndonjë fushatë edukimi për gratë; mundësinë që, gjatë zgjedhjeve, partitë politike të dominuara nga burrat të përdorin votat e grave për të përfituar ata vetë; mungesën e vëmendjes ndaj nevojës për të kuptuar dhe për të kapërcyer pegesat lidhur me pjesëmarrjen e grave në votime (p.sh., detyrimet familjare); rrugën e shpejtë që po ndiqet në përgatitjen për zgjedhjet, situatë kjo që lë pak kohë në dispozicion për edukimin e grave. Së fundi, informacioni i mbledhur deri më tash nga OSBE-ja gjatë regjistrimit të votuesve nuk është i disagreguar sipas seksit.

Të Drejtat e Njeriut

Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm në Këshillin e Sigurimit më 12 korrik 1999 thekson se: “Në kryerjen e detyrave të tij, UNMIK do të udhëhiqet nga standartet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të cilat do të shërbejnë si bazë për ushtrimin e autoritetit të UNMIK-ut në Kosovë. UNMIK do të mishërojë kulturën e të drejtave të njeriut në të gjitha fushat e veprimtarisë dhe do të bazohet në politikën e të drejtave të njeriut gjatë zbatimit të funksioneve të tij administrative.⁵ Respektimi dhe nxitja e të drejtave të njeriut dhe e parimeve të qeverisjes demokratike duhet të jenë, pra, në thelb të të gjithë punës së administratës së përkohshme.

Në 6 dhjetor 1999 OSBE-ja botoi dy raporte mbi të drejtat e njeriut, të cilat dokumentonin shkelje në shkallë të gjerë të të drejtave të njeriut në Kosovë. Raporti i parë, *Kosovo/Kosova – Parë dhe Treguar*, mbulon periudhën nga dhjetori 1998 deri në qershor 1999 dhe arrin në përfundimin se forcat jugosllave dhe serbe kanë shkeluar dhe abuzuar në një shkallë të gjerë ligjet që qeverisin konfliktet e armatosura. Viktimat e tyre ishin thuajse gjithmonë shqiptarët e Kosovës. Raporti i dytë, *Parë dhe Treguar, Pjesa II* mbulon periudhën mes 14 qershorit dhe 31 tetorit 1999 dhe dokumenton shkeljen e të drejtave të pakicave.

Deri më 28 mars në Kosovë ishte krijuar posti i Avokatit të Popullit, i cili do të ketë për detyrë të hetojë dhe të raportojë mbi ankesat për shkelje të të drejtave të njeriut dhe të keqadministrimit. Avokati i Popullit do të analizojë dhe do të ndreqë veprime që përbëjnë abuzim të autoritetit nga ana e administratës civile të përkohshme ose nga institucione të tjera lokale e qendrore që mund të krijohen. Avokati i Popullit dhe vëshguesit ndërkombëtarë, OJQ vendase, si dhe proceset juridike do të vazhdojnë të punojnë në mbrojtje të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore “nga jashtë”, kurse Departamenti i Mbështetjes për Qeverisjen Demokratike dhe Shoqërinë Civile (DGCSS) do të punojë “nga brenda”.

Njëkohësisht, Zyra për të Drejtat e Njeriut në Beograd, e cila u krijua nga Zyra e Komisionerit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut (OHCHR),⁶ i ka kërkuar Ministrin të Drejtësisë të RFJ një listë të të gjithë kosovarëve të ndaluar/arrestuar në Kosovë para marsit 1999, një listë të të gjithë atyre që mbahen në Serbi pas kësaj date dhe të të gjithë atyre që janë liruar nga burgjet serbe. Po ashtu, Zyra e të Drejtave të Njeriut i ka kërkuar Ministrin të Drejtësisë që të vizitojë disa burgje në Serbi për të parë kushtet e grave, të fëmijëve dhe të moshuarve ose të sëmurëve nga Kosova që mbahen në këto burgje.

Duhet të theksojmë këtu se, në kuadrin e profilit demografik të Kosovës, ka një shqetësim të përgjithshëm lidhur me gjendjen e pakicave, veçanërisht të grave dhe vajzave, si dhe për pasojat që kjo situatë ka për të drejtat e njeriut. Në mënyrë të veçantë është shprehur shqetësim, mes të tjerash, për

⁵Raport i Sekretarit të Përgjithshëm, S/1999/779.

⁶Zyrat e të drejtave të njeriut në ish-Jugosllavi u krijuan duke filluar nga 1993. Në fillim detyra e këtyre zyrave ishte të mbështesnin mandatin e Raportuesit Special (SR) të Komisionit të OKB-së për të Drejtat e Njeriut (CHR). Baza ligjore për praninë e këtyre zyrave është një rezolutë vjetore e CHR, e cila e zgjati mandatin e SR dhe i kërkoi Sekretarit të Përgjithshëm të përkrahë SR përmes zyrave në terren.

popullsinë rome (kush po i ndihmon ata për të mbijetuar mes shqiptarëve dhe serbëve), si dhe të pakicave serbe e boshnjake në zonat e populluara kryesisht nga shqiptarë. Duke marrë parasysh se numri i pakicave në Kosovë e në përgjithësi në Evropën Juglindore po rritet, ka të dhëna se gjendja e grave dhe vajzave po përkeqësohet. Në këtë kuadër, mund të pritet që Avokatit të Popullit në Kosovë dhe zyrës së OHCHR për të drejtat e njeriut në Beograd dhe në zona të tjera të RFJ t'ju kërkohet të mbikqyrin respektimin e të drejtave të personave që i përkasin pakicave dhe të ndërhyjnë në emër të tyre në rastet kur është e përshtatshme dhe/ose e mundshme.

Media

Dihet se një media e pavarur dhe e respektuar është një gur themeltar për zhvillimet demokratike. Mbi bazën e punës së bërë gjatë kohës kur refugjatët kosovarë ishin të strehuar në Maqedoni dhe Shqipëri, janë zhvilluar një numër i rëndësishëm programesh për të nxitur të drejtat e njeriut dhe për të mbështetur zhvillimin e medias së pavarur. Vazhdimi i punës në këtë fushë ka përfshirë: (a) inkurajimin e gazetarëve profesionistë që të krijojnë një kod etik mbi baza vullnetare; (b) organizimin e vazhdueshëm të tryezave të rumbullakta me gazetarë kosovarë dhe donatorë ndërkombëtarë për të diskutuar mbi strategjitë e zhvillimit të medias. Këto strategji përfshijnë krijimin eventualisht të një agjensie ose komisioni të pavarur që do të jetë përgjegjës për dhënien e licensave dhe rregullimin e transmetimit të radios e televizionit. Komisioni i Përkohshëm për Median (IMC), i propozuar nga DGCSS, është konceptuar si struktura që do të jetë përgjegjëse për dhënien e licensave dhe rregullimin e transmetuesve. DGCSS është angazhuar të sigurojë që administrata në Kosovë të respektojë dy parimet bazë që administrojnë marrëdhëniet mes autoriteteve publike dhe medias, d.m.th.,: (a) të veprojnë në emër të interesit publik për të ruajtur e siguruar besimin publik; dhe (b) të ketë të drejtën të kërkojë llogari, kur në një institucion të medias angazhohen në mënyrë të drejtpërdrejtë fondet publike.

Strukturat e Përbashkëta të Përkohshme Administrative (JIAS)

Në 4 janar 2000 Këshilli Administrativ i Përkohshëm ra dakort të fillojë përgatitjen e rregullave për të përcaktuar kompetencat e 20 departamenteve që do të krijoheshin nën JIAS, në bashkëpunim me zyrën ligjore të UNMIK-ut. Të njëzet departamentet janë: bujqësia; autoriteti qendror dhe fiskal (buxheti dhe

financa); siguria civile dhe përgatitja për raste urgjente; kultura; mbështetja për qeverisjen demokratike dhe shoqërinë civile; arsimit dhe shkenca; mjedisi; shërbimet publike; shëndetësia dhe sigurimet shoqërore; drejtësia; puna dhe punësimi; administrata lokale; çështje të personave që nuk janë banorë; posta dhe telekomunikacioni; rindërtimi; sportet; tregëtia dhe industria; transporti dhe infrastruktura; shërbimet publike; dhe rinia. Drejtimi i departamenteve administrative iu shpërnda partive politike – Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe Partisë së Progresit Demokratik të Kosovës (PPDK) – të cilat i udhëheqin këto departamente së bashku me zyrtarë të UNMIK-ut. Vetëm Departmenti i Demokratizimit dhe Shoqërisë Civile iu dha një të pavaruri. Deri në prill 2000 katër departamente nuk kishin ende drejtues. Këto janë departamentet që janë caktuar të drejtohen nga përfaqësues të grupeve të tjera etnike (bujqësia dhe puna e punësimi – serb; mjedisi – boshnjak; transporti dhe infrastruktura – turk).

Në 1999 asnjë grua nuk u caktua të marrë pjesë në Këshillin Tranzitor të Kosovës. Gratë kosovare kanë marrë pjesë gjerësisht në sistemin paralel politik. Angazhimi i tyre në nivel rajonal dhe lokal ka qenë një faktor kyç gjatë luftës dhe gjatë rindërtimit. Ky realitet nuk është marrë në konsideratë gjatë proceseve të rehabilitimit dhe në krijimin e strukturave të reja administrative. Për shembull, nga 20 departamente administrative, vetëm 2 drejtohen nga gra dhe vetëm njëra prej tyre është e pavarur (nuk përfaqëson ndonjë parti politike). Në mars 2000 statistikat e OSBE-së dëshmonin se, ndërsa 20% e forcave policore vendase në Kosovë janë femra, vetëm 6% e forcave policore të OKB-së ishin të tilla.

Departamenti për Mbështetjen e Qeverisjes Demokratike dhe të Shoqërisë Civile (DGCSS)

Ky departament është projektuar si vëzhgues me detyrën që të këshillojë dhe të nxisë respektimin e të drejtave të njeriut dhe të standarteve demokratike në administratën e përkohshme në Kosovë, në forcat e policisë dhe në të gjitha strukturat e qeverisjes që janë në formim e sipër. Po ashtu, ky departament synon të luajë rol udhëheqës në JIAS për të nxitur barazinë nga perspektiva e përkatësisë gjinore dhe për të siguruar që kjo barazi të garantohet nga ligjet e të zbatohet në praktikën administrative. Departmenti do të bashkëpunojë me grupet e shoqërisë civile në fushën e problemeve të grave dhe do të përdorë burimet e këtyre grupeve për të promovuar këto çështje. Si pjesë e strukturës së JIAS, Departmenti do të përpunojë dhe do të zbatojë parimet dhe strategjitë e të drejtave të njeriut dhe të qeverisjes demokratike lidhur me: (a) mbrojtjen e strukturave të pavarura dhe të institucioneve autonome nga ndikimi i padrejtë i strukturave qeveritare; (b) krijimin e kushteve për bashkëveprimin mes strukturave të pavaruar e OJQ-ve dhe administratës; (c) ndihmën për departamentet e tjera administrative, në mënyrë që ato të zbatojnë standartet përkatëse të të drejtave të njeriut dhe të qeverisjes demokratike.

Në prill 2000, DGCSS po planifikonte të realizonte punën përmes pesë njësive funksionale. Sipas këtij plani, njësitë do të jenë: Zyra e Politikave të të Drejtave të Njeriut; Zyra për Qeverisjen Demokratike; Bordi për Mundësi të Barabarta (EOB); Zyra e OJQ-ve dhe Zyra e Mbështetjes për Median e Pavarur. Zyrat do të kenë borde këshillimore të pavarura që do të ofrojnë sugjerime në fushat përkatëse.

Bordi për Mundësi të Barabarta do të jetë një strukturë themelore lidhur me problemet e grave, sepse ai do të përpqet që strategjitë, legjislacioni dhe regullat që do të përgatiten nga JIAS, të mbajnë parasysh perspektivën e përkatësisë gjinore dhe ta përfshijnë këtë perspektivë në të gjithë fushat e veprimtarisë. EOB do të përpqet të sigurojë mundësi të barabarta dhe të mbrojë individët e grupet nga çdo lloj diskriminimi, sipas përkufizimeve të bëra në dokumentat ndërkombëtare, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në diskriminimin për shkak të seksit, moshës, orjentimit seksual, besimit fetar dhe racës. Ky bord do të fokusohet në të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe do të nxisë e mundësojë integrimin e këtyre personave në tregun e punës, në jetën politike dhe në sektorë të tjerë të shoqërisë. Po ashtu, do të bëhen përpjekje për të bërë të mundur që persona me aftësi të kufizuara të mund të hyjnë në ndërtesat publike e të marrin pjesë në procese të ndryshme.

SHTYLLA IV: RINDËRTIMI EKONOMIK, i administruar nga Bashkësia Evropiane

Shtylla IV ka katër përparësi:

- ndërhyrjen emergjente për të rinisur veprimtaritë ekonomike bazë dhe shërbimet publike, si dhe përgatitjen për dimër;
- vendosjen e dialogut me bizneset lokale dhe me ekspertët në fushën e ekonomisë;
- krijimin e mjeteve bazë për menaxhimin e politikave ekonomike;
- mobilizimin e ndihmës financiare dhe asaj teknike nga donatorë të huaj.

Kjo punë po realizohet në pesë faza të integruara. Faza e parë pothuajse është kryer dhe faza e dytë është në zbatim.

Faza I: *Krijimi i strukturave administrative, vendosja e trupave të policisë civile ndërkombëtare, sigurimi i ndihmës urgjente për refugjatët që po kthehen dhe për personat e zhvendosur, rivendosja e shërbimeve publike, trejnimi i policëve dhe i juristëve vendas, zhvillimi i një plani të rigjallërimit ekonomik në disa faza dhe synimi për të ndërtuar një ekonomi që mbështet në burimet e vendit.*

Kosova është një nga rajonet më të varfra në Evropë dhe ka qenë një nga pjesët më pak të zhvilluara të Jugosllavisë. Në dhjetë vitet para ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë ekonomia paralele e zhvilluar nga shqiptarët e Kosovës nxiste aftësitë ndërmarrëse dhe krijimin e rrjeteve për të mbështetur biznesin e vogël. Që nga momenti i pushimit të zjarrit dhe i kthimit të refugjatëve në 1999, sektorë të ndryshëm të kësaj ekonomie alternative janë ende të shëndetshëm. Përpjekjet ndërkombëtare për të rindërtuar ekonominë kanë filluar me një projekt të zhvilluar nga Fondi i Bankës Botërore për Zhvillimin e Bashkësisë. Qëllimi i këtij projekti është të ndihmojë projekte të vogla në nivelin e bashkësisë për të përmirësuar kushtet e jetesës së njerëzve. Fondi drejtohet nga një bord që përbëhet 100% nga vendas. 50% e tyre janë gra. Sidoqoftë, ka nevojë për një financim afatgjatë për zhvillimin e sektorëve dhe zonave të ndryshme në Kosovë. Po ashtu, ndërkohë që duhet pohuar se gratë në Kosovë tani kanë më shumë mundësi për t'u punësuar, mundësitë më të shumta janë të përshtatshme për gra të reja, me nivel të lartë arsimor dhe të pamartuara. Si pasojë, vazhdon të ndihet nevoja për trejnimin dhe ritrejnimin e grave të tjera për të rritur aftësinë e tyre për të marrë pjesë dhe përfituar nga rindërtimi ekonomik. Si në shumë vende të tjera të botës, gratë e Kosovës do të përfitonin nga trejnime në vendin e punës, nga punësimi me kohë të pjesshme, nga orë pune fleksibël, si dhe nga aftësimi në punët e fermës – vozitja e traktorit, trejnim i përgjithshëm bujqësor dhe në hortikulturë.

Faza II: Administrimi i shërbimeve shoqërore dhe atyre publike; konsolidimi i rregullit dhe i sundimit të ligjit; përgatitja për zgjedhjet.

Që prej vitit 1989 sistemet dhe strukturat shoqërore në Kosovë ishin të ndara sipas përkatësisë etnike, të dominuara nga kontrolli serb nëpërmjet strukturave formale të RFJ. Në situatën pas konfliktit është bërë e qartë se Serbia ka mundësi të ndikojë në sigurimin e shërbimeve bazë për serbët e Kosovës, të cilët kanë qëndruar në zona të caktuara si, p.sh., pjesërisht në Mitrovicë, në Kosovën veriore. Strukturat familjare tradicionale të shqiptarëve të Kosovës, të cilat lidhnin zonat urbane me ato fshatare, u shkatërruan nga konflikti. Është e paqartë se në ç'mënyrë iu përgjigjën nevojave të bashkësisë strukturat paralele të shqiptarëve të Kosovës, duke marrë parasysh zhvendosjen e refugjatëve dhe të

njerëzve që u kthyen. Disa fragmentime të këtyre strukturave janë konsideruar si baza e fuqisë relative të rrjeteve të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe të ish-Ushtrisë Çlirimtare për Kosovën (UÇK) në zona të ndryshme të Kosovës.

Nuk ka ende një plan konkret për realizimin e të tri fazave finale të Shtyllës IV. Këto faza përfshijnë:

- Përgatitjen dhe kryerjen e zgjedhjeve për Pushtetin Tranzitor të Kosovës.
- Ndhimën ndaj përfaqësuesve të zgjedhur në Kosovë me qëllim që të organizojnë dhe të krijojnë institucione provizore për vetëqeverisje demokratike dhe autonome. Porsa të krijohen këto institucione, UNMIK do të transferojë tek ato përgjegjësitë e tij administrative, ndërkohë që do të vazhdojë të mbështesë konsolidimin e institucioneve provizore të Kosovës.

- Përcaktimin e fazës përfundimtare, sapo t'i jepet një zgjidhje përfundimtare çështjes së statusit të Kosovës. UNMIK do të mbikqyrë kalimin e pushtetit nga institucionet provizore të Kosovës në institucionet që do të krijohen sipas kësaj zgjidhjeje politike.

KONKLUZIONE

Që prej përfundimit të ndërhyrjes së NATO-s në 1999, dëshira e kosovarëve për të ndihmuar zyrtarët e UNMIK-ut në fusha të ndryshme si dhe kapaciteti i tyre për t'u vetorganizuar është penguar ose bllokuar në disa fusha kryesore. Arsyet për këtë janë të ndryshme dhe përfshijnë, për shembull,:

- Ngadalësinë e proceseve burokratike ndërkombëtare dhe dublikimin e përpjekjeve.
- Ndërrimin e shpeshtë ose procesin e rotacionit të stafit ndërkombëtar. Kjo ka shkaktuar pakënaqësi në disa vendas, të cilët duhet të kalojnë orë të tëra nëpër mbledhje ku duhet të infomojnë zyrtarë që kanë shumë pak njohuri për këtë rajon e, më pas, vetëm pas pak muajsh, këta zyrtarë që kanë fituar tashmë ca ekspertizë lidhur me Kosovën, largohen.
- Dështimin në planifikimin e përpjekjeve për rindërtim në zgjidhjen e problemeve të tilla të rëndësishme të infrastrukturës, siç është komunikacioni.
- Proceset e stërzgjatura të përzgjedhjes dhe të marrjes në punë të ekspertëve ndërkombëtarë, të cilët kanë kontribuar në thellimin e mosbesimit të vendasve lidhur me “biznesin” e rindërtimit.
- Paftësinë e zyrtarëve të UNMIK-ut për të marrë në konsideratë nevojën për të krijuar e vendosur struktura të qarta e të dukshme demokratike brenda vetë strukturave të UNMIK-ut, si një shembull i mirë i qeverisjes demokratike.

Mund të thuhet se gjatë administrimit të procesit të ndryshimeve shoqërore, ekonomike dhe politike në Kosovë ka pasur diskriminim të grave. Për pasojë, kontributi potencial i grave është injoruar dhe disa herë është penguar. Kjo është bërë e qartë, për shembull, në:

- Mungesën e vëmendjes së bashkësisë ndërkombëtare për të përfshirë problemet e përkatësisë gjinore *brenda* proceseve politike dhe të përpunimit të strategjive.
- Mungesën e vendosjes së grave në një numër postesh kyçe lidhur me marrjen e vendimeve.
- Paftësinë për të vënë re rolin e grave kosovare në zhvillimet aktuale politike – marrjen në konsideratë të punës së tyre në sistemin paralel që prej vitit 1990, pjesëmarrjen e tyre në luftë dhe angazhimin e tyre shumë të rëndësishëm në proceset e rindërtimit në nivel lokal dhe rajonal në Kosovë që prej vitit 1999.
- Lënien mënjane të nevojave të grave që kanë humbur pjesëtarët meshkuj të familjes dhe që për pasojë, janë bërë kryetare familjesh.
- Përsëritjen e idesë se gratë në Kosovë nuk kanë “përgatitje kulturore” për t'u bërë partnere në zhvillimet politike në rajon ose në nivel lokal.
- Përsëritjen e idesë se gratë janë viktima dhe, për këtë arsye, ato thjesht kanë nevojë për ndihmë e nuk mund të jenë partnere aktivë në proceset e rindërtimit.

- Mungesën serioze të trajnereve feministe në të gjitha fushat për stafin e OJQ-ve ndërkombëtare, agjensive të OKB-së dhe të OJQ-ve vendase.

- Rritjen e shfrytëzimit seksual të grave, të trafikimit, të prostitucionit të detyruar, të ngacmimeve seksuale.
- Pabarazinë në numrin e burrave dhe grave që punojnë në OJQ ndërkombëtare, në OKB dhe OSBE.
- Mungesën e ndërgjegjësimit të shumicës së punonjësve ndërkombëtarë dhe vendas për probleme të përkatësisë gjinore.
- Paaftësinë për të ofruar trajnim në aftësitë menaxhuese për gratë që punojnë për OJQ vendase.
- Tendencën e disa vendim-marrësve në UNMIK për të punuar nga lart-poshtë dhe për t'u konsultuar vetëm me ata që perceptohen si personat më të fuqishëm (meshkuj); kjo mënyrë nuk ka lejuar që në strukturat e krijuara të dëgjohet edhe zëri i drejtuesve vendas të bashkësisë, i OJQ-ve vendase dhe i sektorëve më të gjerë të shoqërisë; një mungesë e tillë e pjesëmarrjes në këto struktura ka krijuar mungesë besimi ndaj tyre.

Është e qartë se konsultime më të gjera mes organizatave ndërkombëtare që punojnë në fushën e problemeve të përkatësisë gjinore në fazat e para të procesit të rindërtimit do të kishin bërë të mundur që procesi të përfshinte më shumë zëra dhe të ishte më koherent. Për shembull:

- Do të ishte evituar krijimi i disa qendrave të grave në të njëjtin vend (në disa raste edhe në të njëjtën rrugë) të financuara nga agjensi të ndryshme ndërkombëtare.
- Do të ishte marrë parasysh se ideja e qendrave të grave nuk është pjesë e asaj që presin gratë vendase.
- Në vend që të financohen OJQ ndërkombëtare për të krijuar qendra të tilla, dialogu i mëtejshëm dhe i thellë me grupet e bashkësisë do të kishte ndihmuar nisma të bazuara mbi ide të larmishme në fusha të ndryshme, nisma që ndikojnë në mënyrë radikale në jetën e përditshme të grave.
- Konsultimet dhe bashkëpunimi mes ekspertëve në fushën e problemeve të përkatësisë gjinore të UNHCR, OSBE-së, UNIFEM-it, dhe Njësisë për Problemet Gjinore të UNMIK-ut do të kishin bërë të mundur që këta individë dhe strukturat përkatëse organizative të kombinonin energjitë e tyre dhe të mbështesnin përfshirjen e problemeve të përkatësisë gjinore në të gjitha fushat e jo vetëm aty-këtu, ose askund, si në disa raste.
- Transparenca në proceset e marrjes së vendimeve dhe të financimit, e shoqëruar me rregulla të qarta, mund të kish mënjanuar konfuzionin dhe pakënaqësinë që krijohet nga fakti që, për shembull, disa grupe vendase që nuk kanë fituar financime, nuk ju është dhënë arsyeja e këtij vendimi dhe nuk janë informuar madje për vendimet lidhur me fondet.
- Mund të ishte mënjanuar ndjesia e grupeve vendase se ekspertiza e tyre merret parasysh vetëm për të financuar projekte përmes OJQ-ve ndërkombëtare, projekte që më pas nuk përfshijnë në punën e tyre OJQ vendase.
- Mungesa e vëmendjes ndaj prirjes së medias ndërkombëtare për t'i portretizuar “gratë ballkanase” si të vjetra, me shami në kokë dhe duke bërë punë fizike në fusha - që në kulturën evropiane do të thotë “të prapambetura” – ka shkaktuar pakënaqësi në shumë nga gratë intelektuale; mund të ishte

mënjanuar po ashtu pakënaqësia lidhur me lidhjen që media bën mes grave me shami në kokë dhe qëndrimeve e besimeve fondamentaliste.

- Një proces më i hapur dhe që përfshin më shumë zëra, mund të kish mënjanuar frustrimin e OJQ-ve vendase që kanë punuar për një kohë të gjatë me gratë fshatare, lidhur me prirjen për t'iu ofruar bashkësive fshatare zgjidhje afatshkurtra si p.sh., kurse për rregullim flokësh, mësim në anglisht dhe rrobaqepësi, pa marrë në konsideratë zgjidhje të mëtejshme që nxisin zhvillimin e tyre.
- Paaftësia për t'iu përgjigjur sa duhet nevojës për botimin, përkthimin dhe përhapjen e materialeve ka bërë që gratë të mos marrin sa duhet informacion mbi çështje që kanë rëndësi për to, si feminizmi, gratë dhe politika, të drejtat e grave, praktikat më të mira e të suksesshme, përkatësia gjinore dhe zhvillimi, dhe çështje të tjera.

REKOMANDIME

Rekomandojmë që:

- **Të përcaktohen objektiva dhe udhëzime në përputhje me Platformën për Veprim të Pekinit** për të inkurajuar përfshirjen e grave në përpjekjet për rindërtim dhe rehabilitim. Objektiva të tilla mund të jenë: (a) të paktën një e treta e vendeve në pozitat kyçe dhe në strukturat këshillimore të jenë nga secila gjini; (b) të sigurohet pjesëmarrja e gjerë e gjithë popullsisë në të gjitha fushat; (c) të reduktohen sektorët e dominuar nga meshkujt ose të feminizuar;
- **Të prodhohen statistika të disagreguara sipas moshës dhe seksit** nga strukturat e UNMIK-ut, përmes mbledhjes së të dhënave dhe procesit të identifikimit të qytetarëve, proces ky që po zhvillohet tani në Kosovë. Një punë e tillë statistikore është një përbërës thelbësor për të çuar më tej punën për integrimin ekonomik, shoqëror dhe politik të grave dhe vajzave;
- **Të forcohen lidhjet mes grupeve ndërkombëtare që punojnë në fushën e problemeve të përkatësisë gjinore** për të mundësuar shkëmbimin e informacionit dhe një bashkëpunim më efikas me burokracinë e OKB-së dhe me grupet dhe gratë vendase.
- **Të ofrohet trajnim i përshtatshëm lidhur me problemet e përkatësisë gjinore për të gjithë personelin burra dhe gra të misioneve ndërkombëtare** para se ata të fillojnë punën në misionet në një rajon të caktuar. Në misione të tilla të vendoset një ekuilibër mes shkallës së përfaqësimit të grave dhe burrave, të paktën në masën 30/70 ose 70/30.
- **Të gjitha raportet e rëndësishme të përkthehen dhe të depozitohen** ose në Bibliotekën Kombëtare, ose në departamentet përkatëse të universitetit – p.sh., raportet e UNIFEM-it mbi dhunën ndaj grave dhe mbi përfshirjen e situatën ekonomike të grave (prill 2000), raporti mbi nevojat dhe burimet, i përgatitur nga Nisma për Gratë Kosovare (maj 2000).
- **Të ofrohet edukim** (p.sh., përgatitja dhe shpërndarja e fletushkave) **përmes medias dhe grupeve këshillimore brenda bashkësive lokale**, veçanërisht për grupet vendase ku bëjnë pjesë një numër i madh grash, për t'i bërë të gjithë njerëzit të ndërgjegjshëm për të drejtat, mundësitë dhe përgjegjësitë e tyre në procesin e zhvillimit të një sistemi demokratik dhe për t'i bërë vendasit të aftë të marrin pjesë në debatin mbi planet për një të ardhme demokratike.
- **Të shmangen anomalitë lidhur me pagesat për vendasit brenda strukturave të UNMIK-ut.** Të tilla anomali kanë krijuar situata ku ekspertët që japin këshilla mbi probleme të edukimit dhe të shërbimeve shoqërore, paguhen më pak se sa shoferët e stafit të UNMIK-ut.
- **Të sigurohet përkthimi i dokumentave, udhëzimeve dhe raporteve në shqip dhe serbisht dhe të ndërmerren hapa në mënyrë që të ketë përkthim në mbledhjet me punonjësit ndërkombëtarë,** në vend që të gjitha mbledhjet të zhvillohen në anglisht, duke e kufizuar kështu pjesëmarrjen e grave.
- **Të ketë më shumë transparencë në procesin e financimit të projekteve dhe të ndarjes së fondeve,** duke përfshirë këtu dhënien e informacionit mbi arsyet e refuzimit të fondeve dhe nëse

procesi i financimit do të jetë i vazhdueshëm; të sigurohet përkthimi i udhëzimeve lidhur me financimet.

- Të krijohet dhe të mbështetet **bashkëpunimi mes ekspertëve në fushën e problemeve të përkatësisë gjinore, intelektualëve dhe aktivistëve në rajon, me qëllim që të mbështeten proceset në në Kosovë si pjesë e Evropës Juglindore**, duke mbajtur parasysh se nisma të tilla rajonale të ndjeshme ndaj perspektivës së përkatësisë gjinore do të kenë pasoja pozitive për shumë vende në këtë rajon.

Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore

Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore u aprovua në Këln në 10 qershor 1999⁷. Ky Pakt do t'i shërbejë forcimit të përpjekjeve të vendeve të Europës Juglindore për të nxitur paqen, demokracinë, respektimin e të drejtave të njeriut dhe prosperitetin ekonomik, në mënyrë që të arrihet stabilitet në të gjithë rajonin. Ato vende të rajonit që synojnë të integrohen në strukturat Euroatlantike, së bashku me një numër pjesëmarrësish të tjerë në këtë Pakt, besojnë se procesi i Paktit të Stabilitetit do të lehtësojë integrimin e tyre në këto struktura.

Shtetet premtuan të bashkëpunojnë, në mënyrë që:

- Të parandalojnë dhe t'u japin fund tensioneve dhe krizave, si një kusht për stabilitet të qendrueshëm, duke përfshirë këtu përfundimin dhe zbatimin e marrëveshjeve dy dhe shumëpalëshe dhe duke marrë masa për të kapërcyer mundësinë egzistuese për konflikt.
- Të krijojnë procese të pjekura politike demokratike, të bazuara në zgjedhjet e lira dhe të rregullta, në ligj dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duke përfshirë njerëzit që i përkasin pakicave etnike, në të drejtën për një media të lirë dhe të pavarur, në një sistem legjislativ që jep llogari para atyre që përfaqëson, dhe në një sistem të pavarur të drejtësisë; të luftojnë korrupsionin dhe të thellojnë e të forcojnë shoqërinë civile.
- Të krijojnë marrëdhënie të paqes e të fqinjësisë së mirë në rajon përmes zbatimit të rreptë të parimeve të Aktit Final të Helsinkit, krijimit të besimit dhe pajtimit; të inkurajojnë punën në kuadrin e OSBE-së dhe në forume të tjera lidhur me masa që krijojnë besimi në rajon dhe mekanizma për bashkëpunim në fushën e sigurimit
- Të ruhet diversiteti multikombëtar dhe multietnik i rajonit dhe të mbrohen të drejtat e pakicave.
- Të krijohen ekonomi të gjalla të tregut të bazuara në politika makroekonomike të shëndosha, të hapen tregjet për një tregti të jashtme të zgjeruar dhe për investimet e sektorit privat, të krijohen tradita dhe të vendosen rregulla tregtare efektive e transparente dhe të zhvillohen tregje të fuqishme të kapitalit e të pronësisë së shumëllojshme, duke përfshirë privatizimin.
- Të nxitet e forcohet bashkëpunimi ekonomik në rajon e mes rajonit dhe pjesës tjetër të Evropës, si dhe botës, duke përfshirë zona të tregtisë së lirë.
- Të nxitin kontaktet e lira mes qytetarëve.
- Të luftohet krimi i organizuar, korrupsioni dhe terrorizmi, si dhe të gjitha veprimtaritë kriminale e ilegale.

⁷Në Mbledhjen e Këlnit morrën pjesë: Ministrat e Jashtëm të vendeve anëtare të Bashkësisë Evropiane, Komisioni Evropian, Ministrat e Jashtëm të Shqipërisë, Bosnje-Herzegovinës, Bullgarisë, Kroacisë, Hungarisë, Rumanisë, Rusisë, Sllovenisë, Republikës Ish-Jugosllave të Maqedonisë, Turqisë, Shteteve të Bashkuara, Kanadasë, dhe Japonisë. Kryetari i Rradhës dhe Përfaqësuesi i Këshillit të Evropës përfaqësonte pjesëmarrësit në Evropën Juglindore. Morrën pjesë edhe përfaqësues të Kombeve të Bashkuara, UNHCR, NATO-s, OECD, WEU, Fondit Monetar Ndërkombëtar, Bankës Botërore, Bankës Evropiane për Investimet dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, të cilët përfaqësojnë Shtetet dhe Organizatat e Konferencës, si dhe përfaqësues të procesit të Roayumont-it, BSEC, CEI, SECI dhe SEECP.

- Të parandalohet zhvendosja me forcë e popullsisë e shkakuar nga lufta, persekutimi dhe konfliktet civile, si dhe migracioni për shkak të varfërisë.
- Të sigurohet kthimi i sigurtë dhe i lirë në shtëpitë e tyre i gjithë refugjatëve dhe personave të zhvendosur, duke i ndihmuar vendet e rajonit në përballimin e barrës që ju ka rënë mbi supe.

- Të krijohen kushtet që vendet e Evropës Juglindore të integrohen plotësisht në strukturat politike, ekonomike dhe të sigurimit që zgjedhin ato vetë.

Për të arritur objektivat e mësipërm, një Tryezë Rajonale për Evropën Juglindore do të marrë në analizë përparimin e bërë në kuadrin e Paktit. Kjo tryezë rajonale do të sigurojë bashkërendimin e veprimtarive mes tri Tryezave të Punës, të cilat do të bazohen në ekspertizën, institucionet dhe nismat ekzistuese. Këto tryeza pune do të përqendrohen përkatësisht në tri fusha: (a) demokratizimi dhe të drejtat e njeriut; (b) rindërtimi ekonomik, zhvillimi dhe bashkëpunimi; (c) probleme të sigurimit.

Në Mbledhjen e Sarajevës, 30 korrik 1999, u përpunua një deklaratë e të gjithë organizmave pjesëmarrës për të përkrahur qëllimet dhe parimet e Paktit, i cili që nga ky moment u vendos nën kujdesin e OSBE-së. Nga perspektiva e analizës që po paraqesim, këtu më poshtë janë përmendur disa pika të rëndësishme në Deklaratën e Sarajevës:

- **Demokracia dhe të drejtat e njeriut** – Bashkëpunimi synon në: përkrahjen e të drejtave të njeriut dhe të qëndrimeve e praktikave të përgjegjësive demokratike, përgjegjësinë personale, lirinë e shprehjes dhe zbatimin e ligjit; ristrukturimin e administratës civile; zgjerimin e lirisë për veprimtari politike dhe të medias së pavarur; ruajtjen e diversitetit multikombëtar dhe multietnik të rajonit dhe mbrojtjen e pakicave;
- **Zhvillimi ekonomik dhe bashkëpunimi** - Heqja e pengesave administrative dhe politike për lëvizjen e lirë të mallrave dhe të kapitalit; përmirësimi i mjedisit për investime dhe zhvillimi i mekanizmave të përshtatshëm për të mobilizuar burimet financiare private dhe për të menaxhuar riskun; vazhdimi, dhe aty ku është i nevojshëm, intensifikimi i përpjekjeve për të krijuar një klimë të parashikueshme dhe të ndershme për biznesin; lufta kundër korrupsionit e krimit dhe vazhdimi i reformave në kuadrin e ekonomisë së tregut, duke përfshirë privatizimin; zhvillimi i mjeteve të veçanta për të mundësuar pjesëmarrjen e firmave nga Evropa Juglindore në rindërtimin dhe zhvillimin në rajon. Pjesëmarrja e këtyre firmave duhet të bëhet përmes një procesi transparent dhe të ndershëm, në përputhje me parime për të cilat është rënë dakort nga të gjitha palët.

Disa nga nismat konkrete më domethënëse të ndërmarra në kuadrin e Paktit që nga Mbledhja e Sarajevës janë: (a) përfundimi i një marrëveshjeje investimi që përfshin angazhimin nga ana e vendeve të rajonit për të përmirësuar mjedisin për investime në këto vende; (b) një nismë kundër korrupsionit si pjesë e një përpjekjeje të gjerë për të luftuar krimin e organizuar; (c) krijimin e një bordi këshillimor për biznesin, i cili do të angazhohet, mes të tjerash, në procesin e Marrëveshjes për Investimet dhe do të ofrojë këshilla lidhur me zhvillimin e sektorit privat; (d) një proces për të identifikuar përparësitë kryesore lidhur me rindërtimin dhe përmirësimin e infrastrukturës, dhe disa nisma në sektorin privat që do të bëjnë të mundur zhvillimin e disa propozimeve konkrete, të cilat do të paraqiten në një konferencë rajonale të donatorëve; (e) zhvillimin e një plani veprimi konkret dhe të integruar, të drejtuar nga disa grupe pune me pjesëmarrjen e aktorëve kryesorë, për një qeverisje të mirë, për edukimin, lirinë e medias, problemet e përkatësisë gjinore, pakicat etnike dhe refugjatët. Duhet vënë në dukje këtu se Komisioni Evropian ka dhënë ndihmesë në Tryezat e Punës – veçanërisht në: propozimin për një rrjet rajonal të organizatave të shoqërisë civile, në zhvillimin e një plani të mjedisit për rajonin dhe një nismë në mbështetje të pakicave rome.

Në kontekstin e Paktit të Stabilitetit, në nëntor 1999 Grupi i Punës për Probleme të Përkatësisë Gjinore (nën OSBE-në) përgatiti një plan veprimi që fokusohet në reforma konkrete në tri fusha të veprimtarisë: fuqizimi politik i grave, legjislacioni elektorale dhe mekanizmat kombëtarë për probleme të përkatësisë gjinore. Sidoqoftë, deri në prill 2000, nuk ishte ende e qartë se çfarë veprimtarish janë zhvilluar në vijim të këtij plani në të tri fushat e përcaktuara më lart.

Në shkurt 2000 u vu në dukje edhe një herë potenciali për konflikt në Ballkan. Në këtë kuadër, u sugjerua që Pakti t'u kushtojë vëmendje dy nismave: krijimit të një Parlamenti Ballkanik dhe krijimit të Klubit Politik të Ballkanit. Lidhur me këto propozime dhe me të tjera propozime që mund të bëhen në të ardhmen, pyetja shtrohet nëse Pakti ka ndikimin dhe mbështetjen e duhur politike për të çuar më tej

qëllime më të gjera politike, d.m.th. të përcaktojnë një përgjigje ndërkombëtare të përbashkët për rajonin që nga Rumania deri në Greqi dhe të bashkërendojë reforma sistematike.

Po ashtu, është vënë në pikëpyetje fakti nëse zyra e vogël e Paktit (në Bruksel) ka profilin e duhur për të arbitruar konkurrencën mes organizatave ndërkombëtare, mes vendeve donatore si dhe mes vendeve rivale të Ballkanit. Pakti presupozon sikur ekziston një politikë e përbashkët evropiane për punët e jashtme dhe për mbrojtjen, gjë që nuk është bërë ende realitetit. Për shembull, ndryshimet mes shteteve anëtare lidhur me sanksionet ndaj Serbisë kanë krijuar pengesa që në fazat e para dhe mbetet të shihet se si do ta përdorë kjo zyrë autoritetin e vet për të realizuar detyrat. Sidoqoftë, fondi prej 2.3 dollarësh amerikanë i premtuar nga bashkësia ndërkombëtare në një mbledhje në datat 28-29 mars 2000, i ka bindur njerëzit se egziston mundësia për të bërë disa ndryshime konstruktive në rajonin e Evropës Juglindore. Disa të tjerë e shohin Paktin më shumë si një “zyrë informacioni” që përpiket të lidhë premtimet e donatorëve me projektet konkrete.

Pas një viti, janë të qarta disa nga arsyet kryesore të pakënaqësisë lidhur me Paktin. Disa prej tyre janë: (a) Pakti është projektuar si një nismë pas konflikteve, por konfliktet ndërkohë vazhdojnë; (b) për sa kohë në Beograd të jetë në fuqi Milosheviçi, objektivi kryesor - integrimi rajonal - do të mbetet tek fjalët; (c) Pakti vuan edhe pasojat e luftrave të brendshme në Bashkësinë Evropiane dhe mes SHBA-së e BE-së; (d) Pakti, më shumë se zgjidhje e problemeve, është kthyer në pjesë të tyre, për shkak të shpresave të mëdha që ka krijuar në rajon, shpresa që nuk janë plotësuar; (e) dështimi kryesor i Paktit është se nuk ka nisur ende një debat konstruktiv lidhur me të ardhmen e rajonit dhe nuk ka hedhur ide të reja të ndryshme në thelb nga ato që janë provuar në Bosnje; (f) nuk janë angazhuar në masën e duhur ekspertë të medias nga rajoni; (g) në përzgjedhjen e projekteve ka pasur një parapëlqim të dukshëm ndaj projekteve që paraqiten nga organizma perëndimorë, të cilët, shpesh, nuk kanë krijuar partneritet me vendasit në shkallën e duhur.

Lidhur me gratë, është sugjeruar që, në kuadrin e Paktit, donatorët duhet t’iu kushtojnë më shumë vëmendje e t’i vlerësojnë më shumë nismat e grave. Gratë në rajon kanë vënë re se ato janë një forcë premtuese për paqen e për ndërtimin e paqes dhe se projektet e grave, ndonëse mund të duken të thjeshta, kanë si qëllim politik përkrahjen e paqes e të stabilitetit.

Konkluzione

Në fillim njerëzit në Evropën Juglindore patën shpresa të mëdha dhe e mbështetën Paktin e Stabilitetit, i cili ka fituar popullaritet edhe mes grupeve të shoqërisë civile dhe OJQ-ve. U mendua se kjo nismë ishte e ndryshme nga politikat e mëparshme të ndjekura nga Bashkësia Evropiane, të cilat përqëndroheshin vetëm tek qeveritë. Po ashtu, njerëzit besuan se ky Pakt nuk do të ketë të bëjë vetëm me mbrojtjen e sigurisë së vendeve, por edhe të sigurisë së individëve. Por, një vit pas fillimeve të Paktit, është pranuar se një nga dështimet kryesore të tij është i natyrës intelektuale. Këtu është fjala për paaftësinë e Paktit për të nxitur një debat konstruktiv lidhur me të ardhmen e rajonit e për të hedhur ide të ndryshme nga ato që janë zbatuar në Bosnje. Disa vëzhgime të tjera lidhur me të kaluarën dhe të ardhmen e Paktit janë:

- Pakti reflekton interesat e organizmave perëndimorë dhe të atyre vendas.

- Donatorët nuk vendosin dot nëse ata duhet të kërkojnë parapakisht nga vendet anëtare ndryshime në standartet dhe institucionet në këto vende, apo duhet të ofrojnë në fillim ndihmë në mënyrë që të ndihmojnë në proceset e reformave e të përshtatjes të këtyre vendeve.
- Është rënë dakort se është e nevojshme të sigurohet ndërveprimi i ngushtë i donatorëve, politikanëve vendas, aktivistëve të shoqërisë civile dhe i organizmave perëndimorë në mënyrë që të arrihen kombinime me përfitim reciprok.

- Pakti nuk ka propozuar ende një strategji për një zhvillim të qendrueshëm dhe vazhdon të mbështetet në disa projekte të ndryshme lidhur me infrastrukturën.
- Përpjekja për të zhvilluar stabilitetin pas konfliktit në një rajon ku konfliktet ende ekzistojnë është një problem të cilit i duhet kushtuar vëmendje.
- Rezultati i zhvillimeve demokratike në Serbi do të jetë një faktor përcaktues lidhur me mundësinë për një demokraci të qendrueshme në Evropën Juglindore.

Rekomandime

Lidhur me punën në të ardhmen dhe me kërkesat ndaj qeverive donatore e strukturave rajonale, rekomandojmë sa më poshtë:

- Të ndiqet zbatimi i propozimeve për zhvillimin dhe bashkëpunimin ekonomik rajonal në kuadrin e Paktit të Stabilitetit.
- Të kërkohen nga donatorët fonde shtesë për projekte ekonomike rajonale që mbajnë parasysh perspektivën e përkatësisë gjinore.
- Puna e Grupit të Punës për Problemet e Përkatësisë Gjinore (Gender Task Force) në Evropën Juglindore të përfshihet në rendin e ditës për një qeverisje të mirë, si, p.sh., në çështjet e edukimit, të medias, të problemeve të përkatësisë gjinore, të pakicave etnike dhe refugjatëve.
- Forumi Këshëllimor i Evropës Juglindore mbi Probleme të Përkatësisë Gjinore të eksplorojë propozimet e Komisionit Evropian për shoqërinë civile, projektet në fushën e mjedisit dhe në mbështetje të pakicave rome.

Mirënjohje dhe falenderime:

Falenderoj të gjithë ata që takova në Kosovë në mars 2000, të cilët iu përgjigjën me durim pyetjeve të mia. Falenderoj, po ashtu, të gjithë anëtarët e Rrjetit të Infomacionit për Evropën Juglindore, të cilët mbledhin dhe shpërndajnë informacion për Vëzhguesit e Paktit të Stabilitetit. U jam mirënjohëse Ariane Brunet (Fondi për Ndërhyrje Urgjente) dhe Mary Diaz (Komisioni i Grave për Gratë dhe Fëmijët Refugjatë) që bënë të mundur vizitën time në Kosovë, si dhe për bisedat tona të gjata e shumë frytdhënëse telefonike! Së fundi, mirënjohja ime iu detyrohet të gjithë miqve feminisitë të Evropës Lindore e Qendrore, pa të cilët nuk do të kisha mundur ta kyeja këtë raport.

Chris Corrin
Glasgow, maj 2000

Qendra për Studimet mbi Gratë
Departamenti i Politikës
Universiteti i Glasgout
GLASGOW G12 8RT
SCOTLAND, UK
Fax: +44 141 330 5071

E-mail: c.corrin@socsci.gla.ac.uk

* * * * *

Takimet e Chris Corrin në Prishtinë – Mars 2000

- *Kryetarët e UNMIK-ut*: Administrata Lokale; Mbështetja për Qeverisjen Demokratike dhe Shoqërinë Civile; Arsimi dhe Shkenca; Shëndeti dhe Sigurimet Shoqërore
- *Anëtarë të*: UNDP-së, UNMIK-ut, Zyrës së UNMIK-ut për Probleme të Përkatësisë Gjinore*, UNIFEM-it*, Nismës për Gratë Kosovare (UNHCR)*, Radios së UNMIK-ut; zyrtarë të OSBE-së për të drejtat e njeriut*, DFID Prishtina, USAID (programi i ndërmarrjeve të vogla e të mesme), Zyra Kanadeze për Mbështetjen e Bashkëpunimit, Programia i Bankës Botërore për Zhvillimin e Bashkësisë; pedagogë të universitetit.
- *OJQ dhe organizata të grave*: Fondacioni Kosovar për Shoqërinë Civile; Grupi i Studimeve mbi Gratë; Motrat Qiriazhi; Rrjeti i Grave të Fshatit; Radio 21; Trupat Ndërkombëtarë Mjekësorë.
- Shënon më shumë se një takim/diskutim.

SHTOJCA

Shkurtime

AI	Amnisti Ndërkombëtare
ANEM	Shoqata e Medias së Pavarur Elektronike
AOR	Fusha e Përgjegjësisë
KMDNJ	Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave (OKB)
CIVPOL	Policia e Kombeve të Bashkuara
QMGF	Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve, Kosovë
CSW	Qendrat e Punës Sociale, Kosovë
CSW	Komisioni i OKB-së për Statusin e Grave
DESK	Zhvillimi i Arsimit në Kosovë
DEVAW	Deklarata për Eliminimin e Dhunës Kundër Grave
DfID	Departamenti për Zhvillimin Ndërkombëtar (UK)
DGCSS	Departamenti për Mbështetjen e Qeverisjes Demokratike dhe të Shoqërisë Civile
DSRSG	Zëvendësi i Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm
EOB	Bordi për Mundësi të Barabarta (DGCSS)
BE	Bashkësia Evropiane
RFJ	Republika Federale e Jugosllavisë
GNP	Prodhimi i Përgjithshëm Kombëtar
HCIC	Qendra Informative Humanitare e Bashkësisë
HRW	Vëshguesit e të Drejtave të Njeriut, USA
IAC	Këshilli Administrativ i Përkohshëm
ICIMPD	Qendra Ndërkombëtare për Zhvillimin e Politikave lidhur me Emigracionin, Austri
ICTY	Gjykata Ndërkombëtare Kriminale për Jugosllavinë
ICCRHD	Qendra Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut dhe Zhvillimin Demokratik
IFRC	Fedrata Ndërkombëtare e Kryqit të Kuq
IMC	Komisioni i Përkohshëm për Median
IMC	Trupat Ndërkombëtare Mjekësore, SHBA
OJQN	Organizata Joqeveritare Ndërkombëtare
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Emigracionin
IRC	Komiteti Ndërkombëtar i Shpëtimit
JIAS	Struktura Administrative e Bashkuar e Përkohshme për Kosovën
JRT	Grupi i Përbashkët për Rregjistrimin
K-FOR	Forcat e NATO-s për Kosovën
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
KPC	Trupat Mbrojtëse të Kosovës
KTC	Këshilli Tranzitor i Kosovës
KVM	Misioni i Verifikimit të OSBE-së për Kosovës
KWECC	Gjykata e Kosovës për Krimet Etnike dhe Luftën

KWI	Nisma për Gratë Kosovare (UNHCR)
LDK	Lidhja Demokratike e Kosovës
MCI	Trupat Ndërkombëtarë të Mëshirës
MQ	Grupi i Grave të Fshatit “Motrat Qiriazit”, Kosovë
FNT	Fondacioni “Nënë Tereza”
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior
OJQ	Organizatë joqeveritare
NUNS	Bashkimi i Pavarur i Gazetarëve Serbë
OSBE	Organizata për Sigurimin dhe Bashkëpunimin në Europë
PPDK	Partia e Kosovës për Progres Demokratik
SRSG	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
UAF	Fondi për Ndërhyrje Urgjente
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
UNFPA	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Veprimtari lidhur me Popullsinë
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
UNIFEM	Fondi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara për Gratë
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
USAID	Agjensia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar
VJ	Ushtria Jugosllave
WHO	Organizata Ndërkombëtare e Shëndetit

SHTOJCË II

Rezoluta e Këshillit të Sigurimit 1244 (1999) mbi situatën në Kosovë